



**PMT**

**Terapia  
psikomotorike**

## ■ Terapia psikomotorike

Nganjëherë te fëmijët bien në sy vështirësitë në fushën motorike. Si pasojë e këtyre vështirësive ata kanë kufizime gjatë ecjes, në mundësinë e të folurit e në mësim, si edhe shpesh kanë pak vetëbesim. Pjesërisht kanë edhe vështirësi në planifikimin dhe në zbatimin e veprimeve të veta. Shpesh e kanë të vështirë të lidhin miqësi dhe të merrren vesh për kompromise.

Terapia psikomotorike është ofertë pedagogjike dhe terapeutike për fëmijët që kanë ngecje në zhvillimin e tyre.

Për terapinë psikomotorike është i nevojshëm udhëzimi mjekësor.

## ■ Sqarim

**Një sqarim psikomotorik mund të japë qartësi, nëse vëren anomali te fëmija i juaj**

- Anomalitë në ekuilibër dhe në koordinim
- Vështirësi në vizatim, në shkrim, në punë dore
- Vetëbesim të ulët, të frikshëm, ose sjellje foshnjore
- Vështirësi në kontakt me fëmijët e tjerë
- Sjellje të shqetësuar dhe të penguar, vështirësi me respektimin e rregullave

### **Sqarimi psikomotorik përfshinë**

- Testin motorik të standardizuar
- Vëzhgimin e lëvizjeve motorike me detyra të strukturuar
- Situata të lira lojërash
- Bisedën për situatën aktuale dhe për parahistorinë

Në bazë të sqarimit vendoset bashkërisht me prindërit se a ka nevojë për mbështetje terapeutike.

## ■ **Terapia psikomotorike: loja, shprehja, përpunimi**

Puna në terapinë psikomotorike orientohet në temat zhvilluese personale të fëmijës, në sjelljen e tij individuale në lojë- dhe në lëvizjet e tij, në shkathtësitë e në botën e tij përjetuese.

Në terapinë psikomotorike punojmë duke vepruar me lojëra, me muzikë, me material specifik dhe me material shprehës krijues. Në këtë mënyrë fëmija ka mundësi në mjedis mbrojtës të njohë aftësitë dhe kufijtë e vet. Ai zgjeron shkathtësitë dhe mëson të merret me vështirësitë e veta.

Nëpërmjet lëvizjes dhe simboleve të lojërave, fëmija mëson t'i shprehë, t'i përpunojë përjetimet, ndjenjat dhe konfliktet e veta.

Fëmijët vijnë në terapinë psikomotorike individualisht ose në grupe të vogla.

## ■ **Fëmija gjen mbështetje**

- në zgjerimin e kompetencave të lëvizjes në fushën grafomotorike të përgjithshme dhe të specifikuar
- në diferencimin e perceptimit kuptimor dhe të ndjenjës trupore
- në zhvillimin e strategjive të reja dhe në zgjidhjen e mundësive që kanë të bëjmë me problemet, veprimet dhe me materialet
- në vetëbesim dhe në vetëveprim
- në zgjerimin e kompetencës shoqërore dhe në aftësitë e komunikimit
- në forcimin e vetëbesimit
- në zbulimin dhe në zhvillimin e mëtutjeshëm të aftësive dhe shkathtësive personale

## ■ **Qëllimi: Përparimi i lëvizjeve dhe i sjelljes shoqërore**

Terapia psikomotorike e ndihmon fëmijën në fushën e lëvizjes dhe të perceptimit. Njëkohësisht i ndihmon fëmijët në fushën shoqërore dhe emocionale, në mënyrë që ata të mund ta përballojnë më lehtë jetën e përditshme.

Në bisedat këshilluese përfshihen edhe personat kujdestarë dhe mësojnë se si duhet të veprojnë në mënyrë adekuat me nevojat specifike të fëmijës.



**Stiftung ptz**

Benzburweg 22

4410 Liestal

Tel. 061 926 63 00

sekretariat@ptz-bl.ch

ptz-bl.ch